



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË**

Numri i lëndës: 2024:307644

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06496712

**PPP.nr.229/24**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri në çështjen përmbartimore të kreditorës M.B.nga Malisheva, të cilin e përfaqëson Asman Hoxha avokat në Prizren, kundër debitorës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e borxhit në shumën prej 598.40 euro në emër të borxhit për kompensimin e shujtave ditore dhe shpenzime të udhëtimit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të paraqitur me datë 11.10.2024 kundër urdhrin përmbartimor P.nr.1058/2024 të datës 26.09.2024 i caktuar nga përmbartuesi privat Liridon H. Tërshani me seli në Prizren, jashtë seancës gjyqësore me datë 22.11.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET si i pabazuar** prapësimi i debitorit Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, i ushtruar ndaj urdhrin përmbartimor P.nr.1058/2024 i datës 26.09.2024, i lejuar nga përmbartuesi privat Liridon H. Tërshani me seli në Prizren.
- II. MBETET NË FUQI** Urdhri për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.1058/2024 i datës 26.09.2024, i lejuar nga Përmbartuesi privat Liridon H. Tërshani me seli në Prizren, për shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 598.40 euro të njohura sipas aktgjykimit C.nr.485/23 i datës 23.08.2024 dhe shumës prej 156.00 euro në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim.
- III. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa e kreditorit për shpenzimet e kërkuara (të paspecifikuara) për përgjigje në prapësim.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi privat Liridon H. Tërshani me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorës M.B.nga Malisheva, të cilën me autorizim e përfaqëson Asman Hoxha avokat në Prizren, ka lëshuar urdhrin numër P.nr.1058/2024 të datës 26.09.2024 me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega e gjykatës në Malishevë/Divizioni Civil C.nr.485/23 të datës 23.08.2024, i cili është bërë i plotfuqishëm nga data 16.09.2024, dhe i ekzekutueshëm nga data 26.09.2024.

Me propozimin për përmbarrim, kreditori ka kërkuar që të caktohet përmbarrimi ashtu që të detyrohet debitori Komuna e Malishevës/Drejtoria Komunale e Arsimit, që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 598.00 € në emër të kompensimit për shujta ditore dhe shpenzimet e udhëtimit sipas aktgjykimit C.nr.485/23, si dhe shpenzimet tjera duke përfshirë edhe shumën prej 156.00 euro për përpilimin e propozimit për përmbarrim.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarrimit me datë 11.10.2024, prapësim ka paraqitur debitori.

Në prapësim debitori ka theksuar se përfaqësuesi i kreditorit i ka shtuar shpenzimet në përmbarrim dhe atë në shumën prej 156.00 euro, ndërsa sipas tarifës duhet të jenë 97.00 euro, pasi vlera e borxhit është 598.00 euro. Ka shtuar se duhet marrë parasysh edhe parimin e ekonomizimit të procedurës, dhe ka kërkuar që përmbarrimi të bëhet me një propozim në mënyrë që të mos lejohen shpenzime shtesë pasi kemi të bëjmë me çështje të njëjtë dhe mund të përmbarrohet me një urdhër përmbarrimor.

Andaj, i ka propozuar gjykatës ta aprovoj prapësimin e komunës së Malishevës si të bazuar dhe urdhrin e përmbarruesit privat Liridon Tërshani ta shfuqizoj si të pabazuar sa i përket shpenzimeve procedurale që ka të bëjë lidhur me përmbarrimin si dhe të vlerësohen këto shkresa në bazë të konkluzionit të gjykatës së Apelit të Kosovës, lidhur me shpenzimet procedurale.

Përgjigje në prapësim me datë 17.10.2024 ka ushtruar i autorizuari i kreditorit i cili ka theksuar se pretendimet e debitorit në prapësim janë të pabazuara, pasi çështja e shpenzimeve është e rregulluar dhe e përcaktuar me nenin 486 të LPK-së.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, i autorizuari i kreditorit ka kërkuar që gjykata të merr aktvendim me të cilin refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbarrimor P.nr.1058/2024 i datës 26.09.2024 dhe të obligohet debitori ti paguaj të gjitha shpenzimet përmbarrimore për përpilimin e propozimit për përmbarrim dhe përgjigje në prapësim sipas tarifës së OAK-së.

#### Vlerësimi i gjykatës dhe baza ligjore

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimit të kreditorit, urdhrorit për përmbarrim, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se:

#### Prapësimi i debitorit është i pabazuar

Gjykata nuk ka caktuar seancë gjyqësore, ngase të dhënat e parashtruara në propozimin për përmbarrim si dhe dëshmitë e bashkangjitura, janë të mjaftueshme për të vendosur rreth kësaj çështje juridiko përmbarrimore.

Me nenin 21 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP) është paraparë që: “*organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”.

Në rastin konkret kreditori ka kërkuar lejimin e propozimit për përmbarrim, sipas dokumentit përmbarrimor-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega e Gjykatës në

Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, me numër C.nr.485/23 i datës 23.08.2024, i cili aktgjykim ka titull përmbarues, duke u bazuar në nenin 22 paragrafin 1, nën par.1.1. të LPP-së ku parashihet se: (Par. 1) *“Dokumentet përmbaruese janë: 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbarues;”*, dhe ky vendim është i përmbarueshëm në bazë të nenit 24 par 1 të LPP-së, ku theksohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushjen vullnetare”,* pasi që i njëjti ka marrë formën e prerë me datë 16.09.2024, si dhe ka skaduar afati për përmbushje vullnetare dhe i njëjti është bërë i ekzekutueshëm që nga data 26.09.2024, si dhe njëkohësisht është edhe i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 27 par.1 të KPP-së, ku thuhet se: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pasi që në aktgjykimin sipas së cilit është lejuar urdhri përmbarimor janë të përfshira të gjitha këto elemente, atëherë gjykata ka vlerësuar së ky vendim i plotëson të gjitha kushtet e lartcekura ligjore për tu caktuar dhe zbatuar përmbarimi sipas tij.

Pra, sipas vlerësimit të Gjykatës, Aktgjykimi në fjalë është dokument përmbarues, i ekzekutueshëm dhe përbën bazë të ligjshme juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim ashtu siç e parasheh neni 24 par.1 i LPP-së.

Në anën tjetër, debitori nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim, siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (LPP), sipas të cilit: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me të cilën do të mund të argumentonte pretendimet e cekura në prapësim, apo se ekziston ndonjëri nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës.

Gjykata ka konstatuar se kreditori, propozimit për përmbarim ia ka bashkangjitur Aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.485/23 të datës 23.08.2024, i cili Aktgjykim është në origjinal, i plotfuqishëm nga data 16.09.2024, dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit–vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*.

Pretendimet e debitorit se kreditori i ka shtuar shpenzimet në përmbarim në shumën prej 156.00 euro, ndërsa sipas tarifës duhet të jenë 97.00 euro, për gjykatën janë të pabazuara, sepse lidhur me obligimin që debitori t’ia paguaj kreditorit shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim në shumën prej 156.00 euro, gjykata është bazuar në rregulloren për tarifatat e avokatëve nr. tarifor 6 për përmbarim në bazë të titullit përmbarimor me vlerë mbi lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pabazuara nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, po ashtu debitori pretendimet e saja nuk i ka mbështetur në prova, ashtu siç kërkohet me nenit 69 par.4 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet e kërkuara, gjykata vendosi si në pikën -III- të dispozitivit të këtij aktvendimi ku kërkesa për kompensimin e shpenzimeve lidhur me përgjigjen në prapësim është refuzuar, për shkak se e njëjta nuk konsiderohet parashtresë në kuptim të nenit 99 të LPK-së, nenit 6.1 të OAK-së, si dhe nenit 2.4 të UA Nr.01/2017 të datës 15.03.2017, për unifikimin e taksave gjyqësore, si dhe pikës 4 të konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, e datës 16-17 mars dhe 26-27 qershor 2023.

Nga të cekurat më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të dispozitave të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore.

**Gjykata Themelore Gjakovë, Dega në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil**  
**PPP.nr.229/24, datë 22.11.2024**

**Gjyqtari**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.